



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

DPSUMK

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 2, Tiranë

Tel/Fax + 4 259 333

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2007

URDHËR

Nr.125 Datë 30.03.2007

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PER DISA SHEQERNA PËR PËRDORIM NJERËZOR"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 41 të ligjit nr. 7941 dt. 31.05.1995 "Për Ushqimin"

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Per disa sheqerna për përdorim njerëzor" bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij urdhëri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

JEMIN GJANA

RREGULLORE

PËR

DISA SHEQERNA PËR PËRDORIM NJERËZOR

Neni 1

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për produktet e pjesës A të Aneksit të kësaj rregulloreje (më poshtë pjesa A e Aneksit).

Kjo rregullore nuk zbatohet për produktet e pjesës A të Aneksit, kur ato janë në formën e kremit të ëmbëlsirave, sheqer i karamelizuar ose masë sheqeri.

Neni 2

Etiketimi

Rregullorja “Për etiketimin e Produkteve Ushqimore” zbatohet për produktet e pjesës A të Aneksit, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

1. Emrat e produkteve që përmenden në pjesën A të Aneksit, pa përjashtuar pikën 5, përdoren për t'i emërtuar ato për qëllime tregtimi.
2. Emri i produktit të pikes 2 të Pjesës A të Aneksit, mund të përdoret gjithashtu për të emërtuar edhe produktin e pikes 3.
3. Produktet e përcaktuara në pjesën A të Aneksit, përveç emrit të detyrueshëm të produktit, zakonisht shoqërohen me terma specifike që përdoren në shtete të ndryshme.
4. Emrat e produktit në pjesën A të Aneksit, përdoren gjithashtu në emërtimin e produktit të përbërë, me kusht që emra të tillë nuk e mashtrojnë konsumatorin.
5. Për produktet e parapaketuara që peshojnë më pak se 20 g, në etikete nuk shënohet pesha neto.

Neni 3

Kërkesa të detyrueshme të etiketimit

1. Në etiketë duhet të shënohet përmbajtja e lëndës së thatë dhe e sheqerit invert, të solucionit të sheqerit, solucionit të sheqerit invert dhe shurupit të sheqerit invert.

2. Etiketa do të përmbajë termin “i kristalizuar” për shurupin e sheqerit invert që përmban kristale në solucion.
3. Kur produktet e përmendura në pikat 7 dhe 8 të pjesës A të Aneksit, përmbajnë me shumë se 5 % fruktoze e shprehur si lende e thate, ato duhet të etiketohen perkatesisht, si “shurup glukoze-fruktoze, “shurup fruktoze-glukoze ” ose “ shurup i thate fruktoze-glukoze” për të pasqyruar nëse komponenti glukoze ose komponenti fruktoze është në përqindje më të madhe.

Neni 4

Kërkesa të mundshme shtesë për etiketimin

1. Kur produkti i plotëson kërkesat e pikes 3 të Aneksit, termi “Sheqer tepër i bardhë” mund të zëvendësohet me termin “Sheqer” ose “Sheqer i Bardhë”.
2. Një produkt i caktuar sheqeri mund të përmbajë në etiketë dhe termat kualifikues , përveç emërtimeve të dhëna në pjesën A të Aneksit, si p.sh”sheqer pluhur”, “fruktozë,sheqer frutash”.
3. Produktet e përcaktuara në pjesën A të Aneksit, lejohen të tregëtohen vetëm kur plotësojnë kërkesat e kësaj rregulloreje, në të kundërt ato nuk lejohen të tregëtohen.

MINISTRI

Jemin GJANA

ANEKSI

A. Përkufizimet dhe emërtimet e produkteve

1. Sheqer gjysëm i bardhë

Saharozë e kristalizuar dhe e pastruar me këto karakteristika:

- | | |
|-----------------------------------|----------------------------------|
| (a) Polarizimi: | jo më pak se 99.5 ⁰ Z |
| (b) përmbajtja e sheqerit invert: | jo më shumë se 0.1% në peshë |
| (c) humbjet gjate tharjes: | jo më shumë se 0.1 % në peshë |

2. Sheqer ose Sheqer i bardhë

Saharozë e kristalizuar dhe e pastruar me këto karakteristika:

- | | |
|---------------------------------|----------------------------------------------------|
| (a) Polarizimi : | jo më pak se 99.7 ⁰ Z |
| (b) Përmbajtje sheqeri invert : | jo më tepër se 0.04% në peshë. |
| (c) Humbjet gjatë tharjes: | jo më shumë se 0.06 % në peshë |
| (d) Ngjyra : | jo më shumë se 9 pike(sipas pikes a, te pjeses B) |

3. Sheqer tepër i bardhë

Produkt që ka karakteristikat e pikave 2 (a), (b) dhe (c) te ketij Aneksi dhe numri total i pikëve (sipas pikës B te ketij Aneksi) nuk kalon 8-tën,dhe jo më shumë se:

- 4 për tipin e ngjyres
- 6 për përmbajtjen e hirit
- 3 për ngjyren në solucion

4. Solucioni i sheqerit ¹

Solucioni uxor i saharozës me karakteristikat e mëposhtme:

- | | |
|-------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|
| (a) lënda e thatë: | jo më shumë se 62 % e peshës |
| (b) përmbajtja e sheqerit invert raporti fruktoze-dekstrozë (1,0 ± 0,2) | jo më shumë se 3 % në peshë të lëndes së thatë |
| (c) përcueshmëria e hirit | jo më shumë se 0,1 % në peshë lëndes thate, |
| (d) ngjyra në solucion | jo më shumë se 45 njësi ICUMSA |

5. Solucion sheqeri invert¹

Solucioni ujqor i saharozes pjeserisht i invertuar nga hidroliza, nq t? cilin p?rqindja e sheqerit invert nuk predominon, me karakteristikat e meposhtme:

- | | |
|-------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|
| (a) l?nda e that? | jo m? pak se 62 % e peshes |
| (b) p?rmbajtja e sheqerit invert raporti fruktoz?-dekstroz? | m? shum? se 3 % por jo me shum? se 50% e pesh?s s? l?ndes s? that? |
| (c) p?rcueshm?ria e hirit | jo m? shum? se 0,4 % e pesh?s s? l?ndes s? that? |

6. Shurup sheqeri invert¹

Solucion ujqor, i kristalizuar, i saharozes pj?serisht e invertuar me hidrolize, ne te cilin p?rmbajtja e sheqerit invert (raporti fruktoze/dekstroze eshte $1,0 \pm 0,1$) duhet te kaloj? 50 % n? pesh? t? l?nd?s s? that?, por q? duhet t? plot?suj? k?rkesat e percaktuara n? pik?n 5 (a) dhe (c) te ketij Aneksi.

7. Shurup glukoze

Solucioni ujqor i koncentruar dhe pastruar i saharideve ushqimore t? p?rftuara nga niseshteja (amidoni)me karakteristikat e m?poshtme:

- | | |
|-----------------------------|-------------------------------------------------------------------|
| (a) l?nda e that? | jo m? pak se 70 % e pesh?s |
| (b) ekuivalent i dekstroz?s | jo m? pak se 20% e pesh?s s? l?nd?s that? e shprehur si D-glukoze |
| (c) hiri sulfat | jo m? shum? se 1 % e pesh?s s? l?ndes that? |

8. Shurup glukoze i that?

Shurup glukoze pjeserisht i thar?, me t? pakten 93 % l?nd? e that?, por q? plot?son k?rkesat e percaktuara n? piken 7(b) dhe (c) t? ketij Aneksi.

¹ P?rshkrimi "I bardh?" ?sht? p?r:

- a) solucioni i sheqerit ku ngjyra n? solucion nuk kalon 25 nj?si ICUMSA,
- b) Solucioni i sheqerit invert dhe shurupi i sheqerit invert tek t? cil?t
 - p?rmbajtja e hirit nuk kalon 0.1%
 - ngjyra n? solucion nuk kalon 25 nj?si ICUMSA (p?rcaktuar me metoda specifike t? analiz?s).

9. Dekstroza ose monohidrati i dekstrozës

D-glukozë e pastruar dhe kristalizuar që përmban një molekulë ujë të kristalizuar me karakteristikat e mëposhtme:

- | | |
|---------------------------|----------------------------------------------|
| (a) dekstrozë (D-glukoze) | jo më pak se 99,5 % në peshë lëndë e thatë |
| (b) lënda e thatë | jo më pak se 90 % në peshë |
| (c) hiri sulfat | jo më shumë se 0,25 % në peshë lëndë e thatë |

10. Dekstroza ose anhidrati i dekstrozës

D-glukozë e pastruar dhe kristalizuar që nuk përmban ujë të kristalizuar, me të paktën 98 % në peshë lëndë e thatë, por që duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara në pikën 9(a) dhe (c) të këtij Aneksi.

11. Fruktoza

D-fruktozë e pastruar dhe kristalizuar me karakteristikat e mëposhtme:

përmbajtja e fruktozës	minimum 98 %
përmbajtja e glukozës	maximum 0,5 %
humbje në tharje	jo më shumë se 0,5 % në peshë
përcueshmëria e hirit	jo më shumë se 0,1 % në peshë

B. METODAT PËR PËRCAKTIMIN E TIPIT TË NGJYRËS, PËRÇUESHMËRISË SË HIRIT DHE NGJYRËS NË SOLUCIONIN E SHEQERIT (TË BARDHË) DHE TË SHEQERIT TEPËR TË BARDHË TË PËRCAKTUAR NGA PIKAT 2 DHE 3 TË PJESËS A TË KËTIJ ANEKSI.

- në rastin e tipit të ngjyrës, 1 pikë = 0,5 njësi ngjyre, (përcaktuar me metoda specifike të analizës).
- në rastin e përmbajtjes së hirit, 1 pike = 0,0018 % hi (përcaktuar me metoda specifike të analizës).
- në rast të ngjyrës në solucion, 1 pikë = 7,5 njësi ngjyre (përcaktuar me metoda specifike të analizës).